



REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA / POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

Hajvali Prishtinë

Nr./Bf.

04-052/2146/2

Data / Datum

16.04.2024

Referencë: **IPK/15042024/DI**

Datë: **15.04.2024**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektimin në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për Procedurën e Planifikimit, Inspektimit dhe Raportimit, si dhe Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli - objekti	- Vlerësimi i aktiviteteve në parandalimin e garave ilegale të shpejtësisë me automjete
Referenca	- 13/2023
Data e inicimit	- 20.12.2023
Data e raportimit	- 15.04.2024
Arsyet e inicimit	- Me datën 20.12.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka autorizuar fillimin e një inspektimi për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave nga struktura përkatëse, në parandalimin e organizimit të garave ilegale të shpejtësisë me automjete, si një dukuri e shpeshtë, shqetësuese dhe e rrezikshme për sigurinë rrugore. Inicimi i inspektimit ka ardhur si rezultat i informatave të mbledhura mbi organizimin dhe zhvillimin e garave ilegale me automjete, që ka kulmuar me incident me tre viktima në Autostradën "Ibrahim Rugova" (në afërsi të Prizrenit). IPK-ja ka mësuar se gara të tilla janë zhvilluar dhe në pjesë tjera të Autostradës "Arbër Xhaferi". Inspektimi ka ofruar mundësi për të vlerësuar mobilizimin dhe përkushtimin e strukturës përkatëse policore në adresimin e kësaj dukurie, që rrezikon sigurinë rrugore.
Objektivat e inspektimit	- Vlerësimi i organizimit dhe kapaciteteve policore (njerëzore dhe teknike), - Vlerësimi i aktiviteteve policore në parandalimin e garave të shpejtësisë, - Vlerësimi i masave të ndërmarra policore në ngritjen e sigurisë rrugore.
Metodologjia e inspektimit	- <u>Takime - intervista</u> me katër (4) drejtues - bartës të funksioneve: (a) Udhëheqësin e Njesisë për Kontrollin e Autostradave, (b) Shefin e Operativës të Njesisë Rajonale të Trafikut Rrugor - Prizren, (c) Shefin e Operativës të Stacionit Policor - Prizren, (d) Shefin e Operativës të Stacionit Policor - Prizren Veriu; - <u>Këqyrje - verifikime</u> : të zonave/lokacioneve ku janë organizuar garat ilegale të shpejtësisë me automjete dhe prezencës së patrullave policore; - <u>Marrje dokumentesh fizike apo elektronike</u> , si: Logu operacional i ngjarjeve ditore të tre muajve të fundit, planet operative nga fusha e trafikut dhe sigurisë rrugore, orare ditore (12.11.2023-16.12.2023), fletë patrulluese (12.11.2023-16.12.2023), raporte të mbikëqyrësve të ndërrimit, raporte statistikore mbi aktivitetet policore, etj.
Subjekti	- Njësia e Kontrollit të Autostradave (NJKA), - Njësia Rajonale e Trafikut Rrugor - Prizren (NJRTR), - Stacionet Policore në Prizren dhe Prizren Veriu.

Afatet e inspektimit	- Fillimi - 21.12.2023; - Përfundimi - 22.12.2023; - Periudha e mbulimit - Tre (3) muajt e fundit dhe gjendja aktuale.
Kriteri vlerësues (standardi)	- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë, - Ligji nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, - Rregullore për Operativë në Policinë e Kosovës, - Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2012 për mënyrën e kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore, - Procedura Standarde e Operimit - Menaxhimi, kontrollimi dhe mbikëqyrja e autostradave të Republikës së Kosovës (8 gusht 2016), - Procedura Standarde e Operimit - Sistemet informative të Policisë së Kosovës (28.10.2021), - Procedura Standarde e Operimit - Koha e reagimit (7 shtator 2018).
Ekipi realizues	- Kushtrim Jonuzi, inspektor, - Xhavit Fetahaj, inspektor.
Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së
Datë	- 15.04.2024



Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet



Inspektimi nxjerrë në pah se:

- ✚ Oraret ditore të angazhimeve në disa raste kanë mungesë informatash mbi detyrat që duhet kryer, ngase janë më tepër formale dhe nuk ofrojnë informacion të detajuar mbi detyrat, duke shtruar nevojën për ngritjen e cilësisë së tyre.
- ✚ Është identifikuar situata kur në fund të ndërrimit është aplikuar raportimi vetëm nga udhëheqësi i ndërrimit, por jo edhe nga patrullat policore. Cilësia e raportimit përmes fletë patrullave ka nevojë të ngritet, për t'i bërë ato më pasqyruese.
- ✚ Në kuadër të NJKA-së nuk mbahet Logu operacional dhe kjo shtron nevojën që edhe kjo Njësi të mundësohet të mbajë një evidencë elektronike lidhur me ngjarjet dhe veprimet operationale, duke siguruar krijim të qasjes on-line përmes Sistemit Informativ të Policisë së Kosovës.
- ✚ Jo gjithëherë disa prej njësive patrulluese iu kanë përmbajtur udhëzimeve dhe rekomandimeve të drejtuesve për të kryer patrullime të kohëpaskohshme në zonat e ndjeshme, por edhe organizimin e pikave të përbashkëta të kontrollit me njësi tjera policore, sidomos gjatë ditëve që kanë qenë të predispozuar për t'u organizuar garat e shpejtësisë.
- ✚ Pamundësia e mbikëqyrjes së auto udhës me sisteme të monitorimit ndikon në ushtrimin efikas të kontrollit rrugor dhe sigurinë e përgjithshme të trafikut.
- ✚ Disa prej segmenteve rrugore që janë në kompetencë të NJKA-së nuk mund të sigurohen se mund të mbikëqyren në mënyrë efektive dhe në kohë, për shkak të gjatësisë së vijës rrugore dhe kjo kërkon rishikimin e politikave aktuale, sidomos kur kemi të bëjmë me reagimin e njësive policore në menaxhimin e aksidenteve.



Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:

1. IPK-ja u rekomandon stacioneve policore të Prizrenit dhe Prizren - Veriu, që gjatë hartimit të orareve ditore, të kujdesen që ato të jenë më përmbajtësore dhe më të detajuara me detyrat brenda ndërrimit.
2. IPK-ja i rekomandon Njesisë Rajonale të Trafikut Rrugor - Prizren, që në përfundim të ndërrimeve, të fillojnë me zbatimin e obligimeve të raportimit përmes fletë patrullave, me që raportimi vetëm nga udhëheqësit e ndërrimeve nuk është i mjaftueshëm.
3. IPK-ja i rekomandon Divizionit të Komunikacionit Rrugor që të sigurojë kushtet për mbajtjen e Logut operacional nga Njësia për Kontrollin e Autostradave.
4. IPK-ja i rekomandon stacioneve policore të Prizrenit dhe Prizren - Veriu, si dhe Njesisë Rajonale të Trafikut Rrugor të Prizrenit, që të zbatojnë në përpikëri udhëzimet për kryerjen e patrullimeve të kohëpaskohshme policore, si dhe organizimin/mbajtjen e pikave të përbashkëta të kontrollit me njësitë tjera, në zonat e ndjeshme të mundshme të organizimit të garave.
5. IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, që në koordinim me Ministrinë e Infrastrukturës, të shqyrtojnë mundësitë financiare dhe teknike për vendosjen e kamerave në auto udhë, drejt kontrollit efektiv të rrugëve dhe ngritjes së sigurisë rrugore.
6. Marrë parasysh vijën e gjatë të kontrollit rrugor dhe reagimin me kohë në rastet e aksidenteve, IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të rishikojë mënyrën e organizimit të Njesisë së Kontrollit të Autostradave, në mënyrë që kjo Njësi në çfarëdo situatë të mund të jetë efektive dhe efektive.

<p>Gjetjet kryesore:</p> 	<p>1. Aktivitetet policore në parandalimin e garave të shpejtësisë me automjete</p> <p>1.1. Organizimi i garave të shpejtësisë me automjete ka një historik jo të afërt, ku sipas Policisë, dyshohet se ato kanë filluar të organizohen qysh nga koha e Pandemisë Covid - 19, për shkak se në atë kohë nuk kanë punuar restorantet, kafeteritë, dhe të rinjtë e kanë shfrytëzuar këtë mundësi për t'u argëtuar. Lidhur me historikun e garave, IPK ka analizuar shkresa dhe informata të ndryshme lidhur me këtë dukuri. Nga kontrolli i logjeve operacionale, IPK-ja ka siguruar informata se përgjatë vitit 2022 në shumë lokacione e rrugë është vërejtur dukuria e garave të shpejtësisë me automjete, si: në rrugët lokale, magjistrale dhe auto udhë. Një inspektim i realizuar në vitin 2022 mbi reagimin e njësive policore në thirrje të qytetarëve, vë në pah thirrje të shumta mbi organizimin dhe zhvillimin e garave në rrugë dhe zona të ndryshme të vendit.</p>  <p><i>Grumbullimet e ndjekësve të garave të shpejtësisë</i></p> <p>1.2. Garat e shpejtësisë me automjete (duke i përjashtuar ato spontane), të cilat kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2023, kanë tërhequr grupe të ndryshme të interesuarish gjatë orëve të mbrëmjes, sidomos në ditët: e Premte, e Shtunë dhe e Diel. Raportimet e tilla mbi zhvillimin e këtyre garave janë hasur në zonat e përgjegjësisë së njësive rajonale të trafikut, stacioneve policore, si dhe njësive përkatëse të kontrollit të autostradave. Përkundër angazhimeve operative në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie, më 16.12.2023 ka ndodhur një aksident i trafikut, si rezultat i zhvillimit të këtyre garave, që ka rezultuar me fatalitet. Lidhur me masivitetin e garave, disa raportime pasqyrojnë se ka pasur raste kur numri i të grumbulluarve ka arritur deri në 250 ndjekës dhe rreth 100 automjete¹.</p> <p>1.3. Garat e shpejtësisë me automjete duke u ngritur në numër, kanë shtyrë NJKA-në që të hartojë Planin Operativ - Parandalimi i garave të shpejtësisë me automjete. Plani i është prezantuar Drejtorit të Divizionit të Komunikacionit Rrugor më 31.03.2023. Plani ka paraparë aktivitete parandaluese në zonat ku operon NJKA në akset R7, R6 dhe në rrugën nacionale M9 (Bresje-Gjurgjicë). Plani është paraparë të realizohet edhe nga personeli i NJRTR të Prishtinës, Ferizajt dhe Prizrenit. Ky Plan është zbatuar për katër (4) muaj rresht dhe pas një ndërprerjeje, është ri-aktivizuar në muajt Nëntor dhe Dhjetor. Edhe në muajt që kanë qenë objekt inspektimi, Plani ka qenë duke u zbatuar nga njësitë përkatëse.</p> <p>1.4. Pas shqetësimeve të ngritura nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Prizrenit, mbi zhvillimin e këtyre garave në zonën e Prizrenit, më 10.11.2023, Drejtori i Divizionit të Komunikacionit Rrugor i ka adresuar shqetësimet te NJKA, që në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Policore - Prizren, të angazhohen në parandalimin e këtyre garave dhe marrjen e masave ndaj shkelësve të rregullave të trafikut. Më 12.11.2023, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka kërkuar nga njësitë përkatëse që <i>“garat e tilla nuk duhet të ndodhin më”</i>. Më 13.11.2023, Drejtoria Rajonale Policore në Prizren ka lëshuar në zbatim një orar angazhimi të NJRTR dhe dy stacioneve policore të Prizrenit, përmes të cilit angazhon këto njësi që të kryejnë patrullime të kohëpaskohshme pranë zonave hyrje-dalje në Autostradë nga ora 19.00-23.00, si dhe pika të përbashkëta të kontrollit gjatë ditëve: e Premte, e Shtunë dhe e Diel (nga ora 20.00-22.00).</p>
---	--

¹ Sipas një Raporti të datës 21.04.2023, patrullat policore të NJRTR - Prizren, në bashkëpunim edhe me ato të stacioneve policore të Prizrenit kanë parandaluar zhvillimin e garave të shpejtësisë tek Kompleksi i pompave të derivateve “Shell” dhe “Kag”, në afërsi të hyrje - daljes në Autostradën “Ibrahim Rugova”.

	<p>1.5. IPK-ja ka pasur në dispozicion oraret e ndërrimeve për periudhën 13.11.2023 - 16.12.2023 dhe ka analizuar kapacitetet patrulluese në kuadër të ndërrimit (15.00-23.00), për cilën ka pasur indikacione se përgjatë saj zhvillohen gara të shpejtësisë me automjete. Inspektimi pasqyron se për periudhën referuese ka pasur angazhim të këtij kontingjenti njësisish policore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Stacioni Policor - Prizren Veriu ka operuar me një (1) patrullë me dy policë, - Stacioni Policor - Prizren ka operuar me një (1) patrullë me 2 policë, - NJRTR - Prizren ka operuar me një (1) patrullë me 2 policë, - NJKA ka operuar me një (1) patrullë me 2 policë². <p>1.6. Ligji Nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor përcakton që mbikëqyrjen dhe rregullimin e trafikut, të mjeteve, të shoferëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë në trafikun rrugor e kryejnë pjesëtarët e policisë. Njësitë policore, të cilat merren me rregullimin, mbikëqyrjen dhe sigurimin e trafikut ndahen në tre (3) nivele dhe përfshinë stacionet, njësitë rajonale të trafikut rrugor dhe njësinë për kontrollin e autostradës. Secila prej tyre ka edhe kompetenca të ndara për mbikëqyrjen dhe kontrollimin e komunikacionit rrugor. Stacionet operojnë brenda zonave të tyre të përgjegjësisë, NJRTR-të në rrugë magjistrale, rajonale dhe brenda Kryeqytetit, kurse NJKA operon në autostrada dhe magjistrale Bresje - Gjurgjicë. Meqë inspektimi është fokusuar tek mënyra e trajtimit të dukurisë së cekur në zonën gjeografike të Prizrenit, ku edhe ka pasur viktimë, edhe inspektimi është përqendruar tek performanca e njësisve policore që kanë mbuluar këtë zonë. Me Planin Operativ - Parandalimi i garave të shpejtësisë me automjete, si dhe Urdhrin e Drejtorit Rajonal të Prizrenit, në aktivitete operative janë përfshirë stacionet policore Prizren dhe Prizren - Veriu, NJRTR - Prizren dhe NJKA.</p> <p>1.7. Sa i përket angazhimit të njësisve policore, është e njohur se stacionet policore hartojnë oraret ditore të angazhimit të burimeve njerëzore brenda ndërrimeve. IPK ka kontrolluar oraret ditore të angazhimit të njësisve policore për periudhën 13.11.2023 - 16.12.2023 dhe gjetjet pasqyrojnë se:</p> <ol style="list-style-type: none"> (a) Oraret e Stacionit Policor - Prizren dhe Prizren Veriu në të shumtën e rasteve përmbajnë lokacionet/zonat që është planifikuar t'i mbulojnë njësitë. Ndarja e detyrave për njësitë policore shpesh nuk ka qenë e qartë, meqë oraret kanë ofruar informacion të përgjithësuar. Derisa i pari në pjesën e shtojcës së Orarit ka pasqyruar detyrat që duhet kryer, tek i dyti mungojnë sqarimet e tilla. (b) Oraret ditore të NJRTR- Prizren kanë përmbajtur lokacionet/zonat dhe detyrat që duhet t'i kryejnë njësitë. Patrullat policore me orar janë njoftuar se ku duhet patrulluar, si lokacione të mundshme të zhvillimit të garave. Lokacionet që kanë kërkuar vëmendje pasqyrohet të kenë qenë mes tjerash edhe: Landovica, Vllashnja, hyrja në Autostradë (kompleksi i pompave të derivateve Shell dhe KAG), etj. (c) Oraret ditore të NJKA-së përmbajnë lokacionet që duhet mbulojnë patrullat policore në auto udhë, të shprehur në numër të kilometrave të rrugës. <p>1.8. IPK-ja ka kontrolluar fletët patrulluese për të verifikuar respektimin e orareve dhe lokacioneve ku janë realizuar aktivitetet patrulluese, ku pasqyrohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> (a) Sa i përket raportimit të aktiviteteve të stacioneve në Prizren dhe Prizren Veriu, zona e përgjegjësisë që lidhet me lokacionet, për të cilat ka pasur informata për organizim të garave, është mbuluar me patrulla. Shpeshherë informatat në fletë patrulla janë përgjithësuar dhe përmendin rrugët kryesore që lidhen me hyrje - dalje të Autostradës "Ibrahim Rugova" (Jugu dhe Veriu), përfshirë këtu rrugët,
--	--

² Sipas Planit Operativ - Parandalimi i garave të shpejtësisë me automjete është paraparë që NJKA të caktojë një patrullë me automjet zyrtar që të patrullojë në Autostradën "Ibrahim Rugova" dhe nga ora 20.00-22.30 patrullimi të përqendrohet në aksin Prizren Veriu - Prizren Jugu. Sipas orareve të NJKA-së dhe udhëzimeve të drejtuesve, ndërrimi i patrullave është paraparë të ndodhë në këtë zonë.


	<p>si: William Walker, Remzi Ademaj, Transiti, Lagjja Arbana, etj. Ka dhe situata kur fletë patrullat tregojnë angazhim të më shumë se një patrulle të paraparë me Orar për zonën e caktuar. Kontrolli i fletë patrullave vë në pah mungesë të konsideruar të organizimit të pikave të përbashkëta të kontrollit me NJRTR.</p> <p>(b) Sa i përket raportimit të aktiviteteve të NJRTR, IPK është shërbyer vetëm me raportet e Mbikëqyrësit të ndërrimit në kuadër të NJRTR, por jo edhe me fletë patrulla. Në mungesë të tyre, raportimet nga mbikëqyrësit e ndërrimeve janë të mangëta dhe nuk pasqyrojnë mjaftueshëm aktivitete operative në terren.</p> <p>(c) Lidhur me aktivitetet e kryera, NJKA ka mbajtur evidenca, që përfshijnë fletë patrullat dhe raportet e mbikëqyrësve të ndërrimeve. Bazuar në fletë patrullat, pasqyrohet se përgjatë periudhës 13.11.2023 - 16.12.2023, NJKA ka raportuar për realizimin e aktivitetit patrullues nga një njësi e rregullt policore përgjatë segmentit rrugor Gjurgjiçë - Vërmicë, që mbulon edhe hyrje - daljet nga Auto udha në zonën e Prizrenit (Veriu dhe Jugu).</p> <p>1.9. IPK-ja ka siguruar Logu operacional për periudhën 01.10.2023 - 16.12.2023 të mbajtur në nivel regjioni (Golf kontroll) dhe është fokusuar në evidentimin e ngjarjeve që lidhen me garat e shpejtësisë me automjete³. Nga gjithsej 23 thirrje të pranuar mbi zhvillimin e garave, IPK ka vërejtur se në njëzetë (20) prej tyre ka pasur reagim, gjë që dëshmohet edhe nga Logu operacional, fletë patrullat dhe raportet e mbikëqyrësve të ndërrimeve, kurse për tre (3) thirrje nuk pasqyrohen veprime të ndërmarra policore⁴.</p> <p>1.10. Patrullat policore në kuadër të aktiviteteve të tyre operative kryejnë patrullime me automjete dhe në këmbë, por organizojnë dhe pika të kontrollit. Veç këtyre masave parandaluese, meqë në trafik shkaktohen kundërvajtje, patrullat shqiptojnë edhe gjoba në drejtim të ngritjes së sigurisë rrugore. Nëse i kthehemi objektit të këtij inspektimi, edhe në këtë rast patrullat policore të tre niveleve që kanë monitoruar zonat e nxehta të zhvillimit të garave, kanë shqiptuar gjoba ndaj shkelësve të rregullave të trafikut rrugor që lidhen me këto gara. Nga informacionet e pranuar pasqyrohet se numri i gjobave të shqiptuara për periudhën 01.01.2023 - 17.12.2023 është si në vijim:</p> <p>(a) Stacioni Policor - Prizren ka shqiptuar 17 gjoba, kryesisht që lidhen me nenin 54 të Ligjit për Rregullat në Trafikun Rrugor,</p> <p>(b) Stacioni Policor - Prizren Veriu ka shqiptuar 62 gjoba⁵,</p> <p>(c) NJRTR - Prizren ka shqiptuar 161 gjoba, që kryesisht lidhen me nenet 13, 31, 54, 56, 58, 70, 112, 116, 117, 187, 203, 204, 231, 233, 250 dhe 253 të Ligjit për Rregullat në Trafikun Rrugor,</p> <p>(d) NJKA ka shqiptuar 373 gjoba që kryesisht lidhen me nenet 54 dhe 161 të Ligjit për Rregullat në Trafikun Rrugor.</p> <p>1.11. IPK është interesuar të njihet edhe me angazhimet tjera të njësisve dhe stacioneve në drejtim të parandalimit të organizimit dhe zhvillimit të garave ilegale të shpejtësisë, ku pasqyrohet që veç patrullimeve dhe gjobitjes së kundërvajtësve:</p> <p>(a) Stacioni Policor - Prizren Veriu ka iniciuar dy raste, ku njëri i është transferuar në kompetencë lëndore Sektorit të Hetimeve Rajonale, kurse rasti tjetër është proceduar në Gjykatën për Kundërvajtje.</p> <p>(b) NJRTR - Prizren gjatë ndërhyrjes për pengimin e zhvillimit të garave ka hasur në rezistencë të disa personave dhe për shkak të kompetencës lëndore, Stacioni Policor - Prizren Veriu ka iniciuar rast penal për “kanosje” (2023-GL-604) dhe</p>
--	---

³ Logu është pasqyrë e krijuar elektronike, me shkrim, ku evidentohen informimet telefonike zyrtare të pranuar nga cilido informues i mundshëm, për një ngjarje të caktuar të ndodhur më parë, apo që është në zhvillim e sipër.

⁴ Thirrjet për të cilat nuk dokumentohet se ka pasur reagim policor nga njësi përkatëse (NJKA): OL-2023-GO-7722, OL-2023-GO-8073 dhe OL-2023-GO-8671.

⁵ Numri prej 62 gjobash lidhet me ngjarjet e organizimit dhe zhvillimit të garave, numër ky i nxjerrë nga totali prej 2.072 gjoba të shqiptuara në zonën ku ka pasur indikacione se mund të zhvillohen garat e shpejtësisë.

	<p>një rast për kundërvajtje për “mos përfillje të urdhrave të personit zyrtar” (2023-GL-605). Lidhur me këtë rast janë arrestuar tre (3) persona dhe janë konfiskuar dy (2) automjete.</p> <p>(c) NJKA në raste kur ka pasur informacione për organizatorët e garave, të njëjtat i ka dërguar në stacione përkatëse policore, varësisht lokacionit ku kanë banuar personat e identifikuar. NJKA ka konfiskuar edhe dhjetë (10) automjete.</p> <p>1.12. Sipas Logut operacional të Qendrës Operative Rajonale Komunikuese - Prizren, me datën 16.12.2024, deri në orën 22.45 kur edhe Shërbimi Emergjent ka informuar për aksidentin e trafikut me fatalitet (si rezultat i zhvillimit të garave të shpejtësisë), nuk ishte evidentuar ndonjë informacion mbi grumbullimin e ndjekësve të garave dhe zhvillimin e tyre. Sipas drejtuesve të njëjësive që janë kujdesur për parandalimin e kësaj dukurie, akterët e përfshirë në këtë garë nuk kanë qenë pjesë e ndonjë grumbullimi ndjekësish në zonat ku kanë ushtruar aktivitetet patrullues njësitë e sipër përmendura në zonën e Prizrenit. Sipas të njëjtëve, akterët e kësaj ngjarjeje me fatalitet kanë ardhur nga rajoni i Gjakovës, kurse garën e kanë zhvilluar në Autostradën “Ibrahim Rugova, në drejtimin nga Veriu në Jug. Aksidenti me fatalitet kishte ndodhur në kilometrin 15 (KM-15) të Autostradës.</p> <p>1.13. Për të vlerësuar angazhimin e njëjësive policore në natën kritike të ndodhjes së aksidentit me fatalitet, IPK ka kontrolluar Logun operacional, oraret e patrullimit, fletë patrullat, raportet e mbikëqyrësve të ndërrimeve dhe raportet e policëve. Nga kontrolli i këtyre materialeve rezultoi se në ditën e aksidentit (datë 16.12.2024, ditë e Shtunë):</p> <ol style="list-style-type: none"> Stacioni Policor - Prizren Veriu nga ora 15.00 - 23.00 ka operuar me një (1) patrullë policore me dy policë me automjetin Police 079-06. Kjo patrullë që në orët e para të ndërrimit ka patrulluar dhe vendosur pika të kontrollit në pjesë të ndryshme të Sektorit I, të cilat janë konsideruar zona të ndjeshme. Por, në intervalin kohor të udhëzuar për vigjilencë të shtuar dhe organizimin e pikave të kontrollit (20.00-22.00), patrulla nuk ka qenë aktive në zonë, sepse është ngarkuar me transportin e një personi në Qendrën e Paraburgimit në Hajvali. Orari i ndërrimit nuk kishte paraparë pika të kontrollit në hyrje - dalje të Autostradës (Veriu). Në këtë periudhë, në zonën e ndjeshme të njohur si zonë potenciale e organizimit të garave kishte pasur angazhim të Mbikëqyrësit të ndërrimit të Stacionit Policor të Prizren - Veriu. Stacioni Policor - Prizren nga ora 15.00-23.00 ka operuar në zonën e ndjeshme me një (1) patrullë policore me 2 policë me automjetin Police 176-06. Patrulla në orët e hershme të ndërrimit ka patrulluar në hyrje - dalje të Autostradës dhe në rrugët që lidhin me të. Por, në intervalin kohor të udhëzuar për kryerjen e patrullimeve të kohëpaskohshme (19.00-23.00), kjo patrullë policore nuk ka qenë aktive në këtë zonë. NJRTR - Prizren nga ora 15.00-23.00 edhe pse është planifikuar të operojë me një (1) patrullë policore me 2 policë me automjetin Police 073-06 në një zonë të ndjeshme, ka qenë e angazhuar në Prevallë, me kërkesë të Ministrisë së Infrastrukturës. Edhe një patrullë e dytë që ka operuar në të njëjtin ndërrim, ka qenë e angazhuar në dy raste me aksidente të trafikut në fshatrat Biraq dhe Bllacë të Komunës së Suharekës. NJKA nga ora 21.00-05.00 është planifikuar të operojë me një (1) patrullë me 2 policë me automjetin Police 615-01, në segmentin e Autostradës Gjurgjicë-Vërmicë. Nga video materialet e siguruara shihet që rreth orës 21.30, patrulla ka frekuentuar hyrje - daljen e Autostradës (Veriu) dhe sipas deklarimeve të zyrtarëve patrullues nuk kanë hasur në grumbullim të njerëzve apo garuesve. Patrulla e NJKA-së pas patrullimit deri në Vërmicë, duke qëndruar në një hapësirë rruge tek kilometri 10 (KM-10) ishte njoftuar nga Udhëheqësi i Ndërrimit për një aksident trafiku. Kjo patrullë ishte angazhuar më pas në vend ngjarje deri në përfundimin e ekzaminimit të vendit të ngjarjes.
--	--

<p>Përfundime</p> 	<p>Nga gjetjet e këtij inspektimi pasqyrohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.1. Organizimi dhe zhvillimi i garave të shpejtësisë paraqet një dukuri sa të përhapur, aq edhe të hershme, që ka karakter të organizuar, por edhe spontan. Këto elemente shpeshherë kanë sfiduar strukturën policore në trajtimin efikas të kësaj dukurie. 1.2. Në drejtim të parandalimit dhe pengimit të këtyre ngjarjeve, që rrezikojnë sigurinë e përgjithshme të qytetarëve, Policia ka vënë në zbatim plane të veçanta operative, të cilat kanë ngarkuar për operim shumë njësi dhe stacione policore, bazuar në kompetencat e tyre territoriale. 1.3. Në muajt e fundit të vitit të kaluar për shkak të intensitetit të shtuar të ngjarjeve të tilla, janë lëshuar urdhra tjerë shtesë në mobilizimin e kapaciteteve operative. Në zonën e Prizrenit ka pasur gatishmëri të një kontingjenti njësisish policore, që të trajtojnë këtë dukuri. 1.4. Meqenëse në zbatim të këtyre planeve operative janë përfshirë stacionet policore, NJKA dhe NJRTR, ato kanë realizuar aktivitete patrulluese operative në kuadër të zonave të përgjegjësisë, por që shpesh kapacitetet e tyre kanë qenë të kufizuara. 1.5. Oraret ditore të patrullimit në të shumtën e rasteve përmbajnë informacione të qarta mbi aktivitetet ditore që duhet realizuar, por ka edhe raste kur oraret e tilla ofrojnë informacion të përgjithësuar, duke mos detajuar detyrat që duhet realizuar. 1.6. Lidhur me aktivitetet e ndërmarra policore hartohen raporte, por që jo gjithëherë ofrojnë informata të detajuar. Shumica e njësisve pasqyrojnë në fund të ndërrimeve aktivitetet e ngjarjet e ndodhura përmes fletë patrullave, por ka raste kur aplikohet vetëm raportimi nga udhëheqësit e ndërrimeve (por jo dhe nga patrullat policore). 1.7. Logu operacional i mbajtur nga Qendra Operative Rajonale Komunikuese (Golf kontroll) në tre muajt e fundit të vitit ka pasqyruar një numër thirrjesh për zhvillim të garave dhe grumbullim të ndjekësve të tyre, por që raportim për reagim ka pasur për 87% të thirrjeve. Teknikisht, NJKA nuk ka të organizuar shërbimin e mbajtjes së Logut operacional dhe inspektimi shtron nevojën e mbajtjes së tij. 1.8. Në drejtim të pengimit të këtyre garave dhe gjobitjen e kundërvajtësve lidhur me to, strukturat përkatëse policore të angazhuara në eliminimin e këtyre ngjarjeve kanë shqiptuar brenda vitit 2023, mbi 600 gjoba brenda zonave të ndjeshme. Janë ndërmarrë edhe veprime tjera, duke përfshirë arrestimin e një numri personash, konfiskimin e automjeteve dhe procedimin e disa rasteve në gjykatat kompetente. 1.9. Inspektimi pasqyron nga materialet e siguruara se në natën kritike kur ka ndodhur aksidenti me fatalitet, nuk ka pasur grumbullim të njerëzve dhe mjeteve në pikat e njohura si zona të ndjeshme, por se auto udha është shfrytëzuar në kalim e sipër, ku nuk ka pasur prezencë policore. 1.10. Me gjithë faktin se në ditën kritike në zonat e ndjeshme nuk ka pasur grumbullim të njerëzve dhe mjeteve në funksion të garave, prezencë policore ka pasur, edhe pse jo efektivisht siç është urdhëruar nga DRP - Prizren, për shkak se disa njësi kanë qenë të angazhuar edhe në menaxhimin e aksidenteve, hapjen e rrugëve nga bora, por kanë pasur edhe kapacitete të kufizuara të burimeve. IPK-ja nuk ka hasur të jenë organizuar mjaftueshëm pika të përbashkëta kontrolli në zonat e ndjeshme. 1.11. Vihet në pah nevoja e vendosjes së kamerave në pjesë të auto udhës, që do të monitoronin gjendjen e sigurisë dhe qarkullimit. Ndarja e zonës së përgjegjësisë së NJKA-së duhet rishikuar, pasi nuk ka kapacitete për të mbuluar nevojat që lindin nga kontrolli efektiv i auto udhës (gjatësia e rrugës nuk siguron arritjen me kohë të patrullave në vend ngjarje, por edhe kontrollin efektiv të saj). 1.12. IPK vlerëson se me gjithë veprimet në identifikimin e organizatorëve të garave, trajtimi i kësaj dukurie kërkon një qasje edhe më pro aktive, duke sensibilizuar opinionin mbi rrezikun që vjen nga këto zhvillime, kontaktimin e personave potencial të organizimit të tyre, si dhe adresimin penalisht të tyre meqë shpesh organizimi i garave rrezikon jetët e pjesëmarrësve në trafik.
--	--

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore ⁶ (në origjinal)	Plani i veprimit
1.	IPK-ja u rekomandon stacioneve policore të Prizrenit dhe Prizren - Veriu, që gjatë hartimit të orareve ditore, të kujdesen që ato të jenë më përmbajtësore dhe më të detajuara me detyrat brenda ndërrimit.	-1-	<u>Stacioni Policor - Prizren</u> Caktimi i detyrave konkrete, do të kërkohet me shkrim dhe do të monitorohen në baza ditore nga Shefi i Operativës dhe stafi komandues tjetër, zbatimimi i këtij rekomandimi. Caktimi i detyrave në baza ditore për secilën patrullë. <u>Stacioni Policor - Prizren Veriu</u> Njësitë patrulluese të Stacionit Policor - Prizren Veriu veç janë duke i dhënë prioritet pikave të kontrollit në oraret ditore të patrullës me detyra përmbajtësore gjatë aktiviteteve të tyre ditore.	Menjëherë
2.	IPK-ja i rekomandon Njësisë Rajonale të Trafikut Rrugor - Prizren, që në përfundim të ndërrimeve, të fillojnë me zbatimin e obligimeve të raportimit përmes fletë patrullave, meqë raportimi vetëm nga udhëheqësit e ndërrimeve nuk është i mjaftueshëm.	-1-	NJRTRR - Prizren bazuar në rekomandimin e raportit nga IPK, do të aplikoj menjëherë formën e raportimit përmes fletës patrulluese. Mbikëqyrësit e ndërrimeve, bazuar në raportimet në fletën patrulluese, plotësojnë raportin e mbikëqyrësit.	Menjëherë
3.	IPK-ja i rekomandon Divizionit të Komunikacionit Rrugor që të sigurojë kushtet për mbajtjen e Logut operacional nga Njësia për Kontrollin e Autostradave.	-1-	Me strukturën e re organizative të PK-së është paraparë që NJKA-ja të ketë edhe zyrën e komunikimit ku mbahet Logu operacional gjë që nuk ka qenë e paraparë deri më tani. Kjo çështje pritet të rregullohet gjatë këtij viti pasi të bëhet zgjidhja për hapësirën në objekt. Me krijimin e kushteve do të iniciohet kërkesa për plotësim të personelit dhe aktivizimin e zyrës së komunikimit.	Në vazhdimësi
4.	IPK-ja i rekomandon stacioneve policore të Prizrenit dhe Prizren - Veriu, si dhe Njësisë Rajonale të Trafikut Rrugor të Prizrenit, që të zbatojnë në përpikëri udhëzimet për kryerjen e patrullimeve të kohëpaskohshme policore, si dhe organizimin/mbajtjen e pikave të përbashkëta të kontrollit me njësitë tjera, në zonat e ndjeshme të mundshme të organizimit të garave.	-1-	Operativa e Stacionit Policor - Prizren do të përpiloj plane veprimi ku do të koordinohen PKA të përbashkëta me NJRKRR në pjesë të ndryshme të zonës sonë me qëllim parandalimi e reagimi të garave me automjete. PKA të planifikohen në daljen Jug të Autostradës, zonat periferike të qytetit dhe rrugët tjera ku ka predispozita se këto gara mund të mbahen, si rruga Tranziti i ri, rrugët hyrëse/dalëse të qytetit me dy shirita në një drejtim, brendia e qytetit, rruga unazore dhe lokacione tjera që mund të vlerësohen si potenciale për këto gara.	Menjëherë

⁶ Komentet e strukturës policore janë përmbajtje e tekstit autentik të saj dhe në to nuk ka pasur ndërhyrje. Komentet janë pranuar me shkrim pas takimit përmbyllës të datës 21.03.2024, të realizuar nga përfaqësues të Departamentit të Inspektimit të IPK-së dhe strukturës policore të inspektuar.

			<p>Stacioni Policor - Prizren Veriu në koordinim edhe me NJRTRR - Prizren, do të bëjnë formimin e pikave të përbashkëta të kontrollit në zona ku dyshohet se do të bëhen gara ilegale të automjeteve, njësitet e patrullës të Stacionit Policor - Prizren Veriu veç janë duke i dhënë prioritet pikave të kontrollit në oraret ditore të patrullës sipas planeve operative aktive, me qëllim që këto plane të realizohen në përgjithësi, si plani operativ "Siguria në komunikacionin rrugor", "Targeti", "Grabitjet", "Sezoni dimëror", etj., përmes planeve të veprimit të cilat do të përpilohen nga Sektori i Operativës me qëllim të reagimit dhe parandalimit të garave të shpejtësisë, sidomos në zonat e ndjeshme dhe të mundshme për organizimin e garave, si te Pompa Shell dhe Kag, Transiti i ri, Lagje Dardani, etj.</p> <p>NJRTRR - Prizren, në bashkëpunim me Stacionin Policor - Prizren Veriu ka mbajtur dhe do të vazhdoj të mbajë pika kontrolli të përbashkëta, përmes planeve të veprimit, të cilat do të përpilohen nga Sektori i Operativës me qëllim të reagimit dhe parandalimit të garave të shpejtësisë, sidomos në zonat e ndjeshme dhe të mundshme për organizimin e garave, si te Pompa Shell dhe Kag, Transiti i ri, Lagje Dardani (rruga Ukë Bytyqi).</p>	
5.	<p>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, që në koordinim me Ministrinë e Infrastrukturës, të shqyrtojnë mundësitë financiare dhe teknike për vendosjen e kamerave në auto udhë, drejt kontrollit efektiv të rrugëve dhe ngritjes së sigurisë rrugore.</p>	-I-	<p>Nga Policia është bërë kërkesë në MMPHI për vendosjen e kamerave në autostrada, do të angazhohemi që me të gjitha institucionet e vendit dhe donatorët të bëhet zgjidhje në monitorimin dhe kontrollimin e trafikut në autostrada edhe përmes pajisjeve teknologjike. Aktualisht NJKA-ja mbështet me veturat me pajisje inteligjente e po ashtu gjatë vitit presim të furnizohemi edhe me radar mobil pasi ekziston kontratë aktive, ku këto pajisje do të jenë në dispozicion edhe për NJKA-në.</p>	Në vazhdimësi
6.	<p>Marrë parasysh vijën e gjatë të kontrollit rrugor dhe reagimin me kohë në rastet e aksidenteve, IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të rishikojë mënyrën e organizimit të Njësisë së Kontrollit të Autostradave, në mënyrë që kjo</p>	-I-	<p>Menaxhmenti i policisë ka vlerësuar rëndësinë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të autostradave me efikasitet dhe efektivitet sa më të lartë ku me strukturën e re organizative është paraparë Drejtoria e Autostradave me dy njësitë e sajë: (1) Njësia për Kontrollin e Autostradës "Ibrahim Rugova" dhe "Arbën Xhaferi" dhe (2)</p>	Në vazhdimësi

	<i>Njësi në çfarëdo situatë të mund të jetë efikasë dhe efektive.</i>	<i>Njësia për Kontrollin e Autostradës Prishtinë - Gjilan dhe Prishtinë – Merdarë, si dhe kompletimi i personelit në të gjitha njësitë sipas strukturës organizative në kuadër të drejtorisë për autostrada.</i>	
--	---	--	--